



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		27.04.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILGG
01-	052/01-	19351	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	27.04.2026
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi– Nënkryetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit. <i>B. Gjilja</i>
Lënda:	Raport nga procesi i konsultimit publik nga Projekt Rregullore për taksat dhe gjobat komunale

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-016/0163314, e datës 26.12.2024 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton raport nga procesi i konsultimit publik të Planit Komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme në Komunën e Lipjanit (2026-2028). Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e Projekt Rregullores për taksat dhe gjobat komunale së bashku me zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Projekt Rregullores për taksat dhe gjobat komunale

Njoftimi për diskutim publik është shpall në afatin e paraparë ligjor, duke u bazuar në dispozitat e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, ashtu palët e interesuara janë njoftuar me datën, vendin, kohën për mbajtjen e takimit publik.

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike dhe linku i platformes për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, ku ka qenë në diskutim publik Draft Plani si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=43001>

<https://lipjan.rks-gov.net/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Statutit në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike kanë publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 27.03.2026 për mbajtjen e konsultimit-debatit **për Projekt Rregullores për taksat dhe gjobat komunale**

në linkun:

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/03/Njoftim-per-Debat-publik-Projek-Rregullorja-per-Taksa-dhe-Gjoba-Komunale-shqip.pdf>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 07.04.2026 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora ora 10:00

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

Linku: <https://lipjan.rks-gov.net/news/mbahet-debat-publik-per-projekt-rregulloren-per-taksat-dhe-gjobat-komunale/>

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 14 pjesëmarrës, prej tyre 8 femra dhe 6 meshkuj.

Debatin me qytetarë për të konsultuar Projekt Rregulloren për Taksat dhe Gjobat Komunale e ka hapur dhe zhvilluar nën drejtimin e Fauz Xhemajli, Kryesues i grupit punues nga Drejtorati për Administratë i cili ka njoftuar të pranishmit për qëllimin e debatit si dhe dispozitat e përgjithshme të Projekt-Rregullore.

Fauz Xhemajli fillimisht para të pranishmëve ka prezentuar dokumentin përkatësisht Projekt – Rregulloren për Taksat dhe Gjobat Komunale qëllimi i së cilës është që është që Komuna të krijoj burime të të hyrave vetanake buxhetore në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal si dhe përcaktimi i gjobave apo sanksioneve kundërvajtëse për rastet e shkeljeve të dispozitave të kësaj Rregulloreje. Ai posaqërisht ka sqaruar disa ndryshime që kanë ndodhur te taksat e gjendjes civile si legalizimi i kurorave 10 €, Regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë martesës (regjistrimi i veqantë) 5 €, te neni 9, pjesa tabelare numri rendor 2, Shfrytëzimi i sipërfaqeve para objekteve të biznesit për veprimtarinë e cila është e lejuar të ushtrohet edhe jashtë objektit dhe për ekspozimin e mallrave të lejuara nga 1€ është ndryshuar në 2 € në bazë mujore për m2.



Gjatë këtij takimi të pranishmit paten rastin të bëjnë pyetje dhe të paraqesin komente rreth këtij dokumenti.

Valdete Muji ka parashtuar pyetjen se me këtë Propozim Rregullorë a janë paraparë taksat edhe për shfrytëzuesit e pronës komunale për 99 vite.

Kësaj pyetje i është përgjigjur anëtarja e Komisionit Vlora Krasniqi e cila ka njoftuar se në nenin 23 të kësaj Propozim-Rregulloreje janë paraparë Taksat për pronat komunale që ipen në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë me vendime të Kuvendit të Komunës, konform dispozitave të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

Ky koment i Valdete Mujit është pranuar nga Komisionin terësisht

Saranda Krasniqi ka kërkuar që Taksat për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale të dallohen sipas zonave .

Vlora Krasniqi edhe këtu e sqaroi komentuesen se te dhënia në shfrytëzim afatshkurtër taksat apo qiraja për lokale dhe objekte afariste është dalluar sipas zonave mirëpo te dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronave të paluajtshme për shkak të numrit të madh të pronave të paluajtshme nëpër fshatra ka qenë e pamundshme të bëhet ndarja nëpër zona.

Komenti i Saranda Krasniqit është pranuar pjesërisht nga Komisioni

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	15 ditë pranohen	14
Publikimi në ueb faqe	15 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 14 pjesëmarrës, prej tyre 8 femra dhe 6 meshkuj.

Komentet e listuara janë nga takimi konsultativ-debati si dhe disa të pranuar në mënyrë elektronike

Temat e konsultimit	komentet	Kush ka komentuar	Pergjegjia ne pyetje komente	Komentet (ptranimi i pjeseshem dhe mos pranimi)
Projekt Rregullore për taksat dhe gjobat komunale	Ka parashtuar pyetjen se me këtë Propozim Rregullore a janë paraparë taksat edhe për shfrytëzuesit e pronës komunale për 99 vite, nese	Valdete Muji	Kësaj pyetje i është përgjigjur anëtarja e Komisionit Vlora Krasniqi e cila ka njoftuar se në nenin 23 të kësaj Propozim-Rregulloreje janë paraparë Taksat për pronat komunale që ipen në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë me vendime të Kuvendit të	Komenti u pranua plotësisht

			Komunës, konform dispozitave të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme dhe akteve nënligjore që derivojnë nga ky ligj.	
Projekt Rregullores për taksat dhe gjobat komunale	Ka kërkuar që Taksat për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale të dallohen sipas zonave .	Saranda Krasniqi	Vlora Krasniqi edhe këtu e sqaroi komentuesen se te dhënie në shfrytëzim afatshkurtër taksat apo qiraja për lokale dhe objekte afariste është dalluar sipas zonave mirëpo te dhënie në shfrytëzim afatgjatë e pronave të paluajtshme për shkak të numrit të madh të pronave të paluajtshme nëpër fshatra ka qenë e pamundshme të bëhet ndarja nëpër zona.	Komenti u pranua plotësisht

Gjatë fazës së diskutimit publik lidhur **Projekt Rregulloren për taksat dhe gjobat komunale**

Komisioni për hartimin e saj ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e pranuar nga palët e interesuara.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike

1. ~~MURR~~ ISMET ÇUROCI
2. ~~Arif~~ Ashim Sopjani
3. ~~Arif~~ Gonimete Berisha Hoti
4. ~~Halim~~ Mevlide Halimi
5. ~~Arif~~ Donita Bytyqi
6. VLORA KRASHI / ~~MURR~~
7. Arim Sardis / ~~Arif~~
8. Rafete Bekocaj / ~~Arif~~
9. Galibe Marave / ~~Arif~~
10. Valdete Muji / ~~Arif~~
11. Belim Zasholli / ~~Arif~~
12. HAZDI ADEMI / ~~Arif~~
13. Feritun Shala / ~~Arif~~
14. Butirje Zajullahu / ~~Arif~~